

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO/ Ministrja Shëndetësisë, Spahiu në Kuvend: Në 2027-ën ose do sjell PET Scan-in, ose do jap dor ëheqjen
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/ministrja-shendetesise-spahiu-ne-kuvend-ne-2027-en-o-se-do-sjell-pet-sca-i586676
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:01:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	199c7bd432be0313cbb2cc50360c7ca04c1d41dbb2068570fc6d91e7a51e8b59
TEKSTI	fcadfd697eb4e7fd9f4d9b44b0aebd4c7f2854c3942d32bd90165f00b120a6
PAMJA	c6397051997132be1455fdb559f136523befb4720a99d2eee8564618a05f668a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	28b240436c132e81206fa2f55e1f069c8d22dc8432afeb6fbdd23f9874fb0180
E MËPARSHMJA	254b1267b6fb1d7fe79dabf0ea8ff780d5f7af83d7fea89bc0ad71d879591465
RRËNJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/28b240436c132e81206fa2f55e1f069c8d22dc8432afeb6fbdd23f9874fb0180>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 
[Kontakt](#)



 English



1e [Arrestime per pronat ne Fier/ Dy ish-drejtores te Kadastres ne pranga, ndertuesi peritoi 1143 ha Denimi i ish-krereve te UÇK/ Leka: Duhet ofensive! Parlamenti i Shqiperise fundit](#)

VIDEO/ Ministrja Shëndetësisë, Spahiu në Kuvend: Në 2027-ën ose do sjell PET Scan-in, ose do jap dorëheqjen



17 Shtator 2026, 14:00Politika TEMA



Interpelanca e ministres së Shëndetësisë, Klodiana Spahiut, në Kuvend u shoqërua me debate dhe ndërprerje nga radhët e opozitës. Në disa momente, diskutimet në sallë detyruan nënkryetaren e Kuvendit, Evis Kushi, të ndërhynte për të vijuar seanca.

Në fjalën e saj, Spahiu u ndal te çështjet që lidhen me shërbimet shëndetësore, duke marrë si shembull shërbimin e dializës dhe mënyrën e ofrimit të tij ndër vite.

“Kjo është interpelanca e parë pasi kam marrë detyrën. Dua të ndalem në çështjet për interpelancë. Po marr si shembull dializën: përshembull në 2004-ën shërbimi ka qenë shumë i kufizuar dhe shumë pacientë shkonin drejt Maqedonisë së Veriut. Prandaj ndërtimi i kapaciteteve publike ka rëndësi të jashtëzakonshme”, deklaroi ministrja.

Spahiu hodhi poshtë gjithashtu interpretimet për një kalim të shërbimeve nga një operator privat te një tjetër, duke theksuar se synimi, sipas saj, është garantimi i vijimësisë së shërbimit për pacientët.

“Pas përfundimit të kontratës shteti merr administrimin për këto shërbime. S'bëhet fjalë për kalimin nga një operator te tjetri, apo për të përgjuar gra e vajza që kanë punuar me mua në 100 orët e para të punës. Marrja në administrim publik nuk është qëllim në vetvete, por pacienti të mos e ndjejë ndryshimin si pasiguri. Pacienti duhet të vazhdojë të marrë shërbimin, pa ndërprerje, dhe me përgjegjshmëri institucionale”, tha ajo.

Ministrja foli edhe për mënyrën e organizimit të shërbimeve dhe theksoi se ndryshimi i emërimit nuk nënkupton, sipas saj, krijimin e një strukture të re private.


“Ndryshimi i emërimit nuk nënkupton krijimin e një institucioni të ri privat, por shoqëri ekzistuese me kapital 100% shtetëror, nuk kemi transferim të kompetencave publike te një subjekt privat”, u shpreh Spahiu.

Në vijim, ajo iu përgjigj edhe kritikave për emërimet dhe stafin, duke deklaruar se do të kërkojë që në administratë të qëndrojnë njerëzit që punojnë dhe përmbushin detyrat.

“Harrojeni që në një pozicion pune do vendoset një burrë, një grua, kushdo qoftë që nuk e ka ritmin tim, do jem javë për javë me ju në interpelancë për të treguar që njerëzit e punës nuk duhen bojkotuar”, deklaroi ministria.

Spahiu e mbylli fjalën e saj me një zotim për angazhimin në sistemin shëndetësor dhe vendosi një afat për realizimin e një prej objektivave të saj.

“Sistemi shëndetësor është aset kombëtar, burimet e këtij aseti kombëtar ju politikanët i keni degjeneruar për arsyet tuaja dhe njerëzit punëtorë që i keni përgjuar për interesat tuaja personale do jenë në krahun tim deri në minutën e fundit edhe sikur një javë të rri në këtë detyrë. Çdo orë të punës do të jem në shërbim të qytetarëve. Nga ora 8 e mëngjesit deri në 8 të darkës unë do të jem aty. Në 2027-ën ose do sjell Pet Scan-in ose do jap dorëheqjen. Mos u merrni me emra grash se do të mbeten burra me damkë”, tha Klodiana Spahiu në Kuvend.



3 Komente



Dire Straits !!!!

17 Shtator 2026, 14:09

Ha Ha Ha Hapo lere moj PET SCAN , ai shefi yt , bojaxhiu , ka qe ne 2013 qe ne cdo zgjedhje thote " do sjell uje 24 ore".....po me nder "ujet e zi" na solli !!!

↩ Përgjigjuni

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Lani

17 Shtator 2026, 14:15

imagjinoje cfar shtet bananesh kemi ne akoma nuk ka PET SCAN o ju shplaft mortja hajduta te poshter skeni turp...vetem me leket qe ka vjedhur balluku bashke me moterqimin Ram I pa afti hajduti poshter..kishim ble nga nje per cdo qytet ..shtet mortje kancer

↩ Përgjigjuni

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Klimax

17 Shtator 2026, 14:28

Në kohën e vampirit Berisha nuk kishte as batanije në krevatet e spitaleve ku muret dhe tavanet me copa suvash të rrëzuara kullonin nga lagështira, pa folur më pas për ilaçe, sistem ngrohje në dhomat e pacientëve, etj, etj.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0

💬 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[FOTO/ Protestuesit përmbysin kazanet e mbeturinave para selisë së PD](#)

12:35 Politika / 10 komente

[Kumbaro në Kuvend: Shqipëria përmirësoi rezultatet në PISA, përzgjedhja e shkollave u bë sipas metodologjisë së OECD-së](#)

12:12 Politika / 5 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.